



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë RBM Assicurazione Salute S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa Nr.32 Prot., datë 16.01.2020 “Njoftim Përqendrimi”, ku përfaqësuesi ligjor ka njoftuar transaksionin e kryer, lidhur me përfitim të kontrollit të shoqërisë RBM Assicurazione Salute S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

Nga pala blerëse dhe pala shitëse është nënshkruar “Kontratë Investimesh”, më datë 19 Dhjetor 2019.

Palët pjesëmarrëse:

Pala blerëse: Intesa Sanpaolo Vita S.p.A është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionin Italian, me objekt veprimtarie: ushtrimin e veprimtarisë së sigurimeve dhe risigurimeve në fushën e jetës, aksidenteve dhe degët e sigurimeve shëndetësore.

Intesa Sanpaolo Vita S.p.A kontrollohet nga grupi Intesa Sanpaolo, e cila është e pranishme në Shqipëri përmes filialit të zotëruar plotësisht prej saj, Intesa Sanpaolo Bank Albania, SHA.

Pala shitëse: RBHold S.p.A, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionin Italian.

Shoqëri Target: RBM Assicurazione Salute S.p.A, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit Italian, me objekt veprimtarie: ushtrimin e biznesit të sigurimeve në lidhje me dëmtimet dhe klasat e aksidenteve, mund të marrë interesa dhe aksione në kompani ose në entitete të tjera, mund të kryejë çdo veprim financiar të luajtshëm dhe të pasurive të patundshme, investime, etj.

RBM Assicurazione Salute S.p.A, zotërohet tërësisht nga RB Hold S.p.A. e cila nuk ka degë apo filial dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.